



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 450/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e paraqitur nga Lëvizja për Grupim Tradicional Shqiptarë (LGTSH), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa nga Lëvizja për Grupim Tradicional (LGTSH).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014 nga Lëvizja për Grupim Tradicional Shqiptarë, me të cilën pretendohet se në rezultatit preliminar të publikuar nga KQZ pa u numëruar të gjitha votat LGTSH në tabelën zyrtare ka pasur 1039 vota, ndërsa në rezultatit përfundimtar të shpallur nga KQZ, LGTSH ka vetëm 270 vota.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që të rishikoj rezultatet dhe të anuloj rezultatet e shpallura si të pasakta, manipulative dhe në mospërputhje me shprehjen e vullnetit të popullit sovran.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë si të përgjithshme dhe të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk e ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar ato pretendime se është bërë ndonjë parregullsi siç ka potencuar në ankesën e tij, si dhe nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku kanë ndodhur shkeljet e pretenduara dhe ku mund të gjenden dëshmitë të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Prandaj në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar, andaj në kuptim të Nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën në fjalë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 450/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*